



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.89, datë 26.07.2021

PËR

NJË NDRYSHIM NË VKB NR.127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME DHËNIEN NË PËRDORIM TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE PAS PROGRAMIT MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme”, Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar, Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 për “Shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, legjislacionit të aplikueshem në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të VKB nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” si më poshtë vijon:

- Pas tabelës nr. 41 të Vendimit nr. 127, datë 24.12.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021", shtohet paragrafi si më poshtë:

“Tarifa për dhënien në përdorim të mjediseve sportive të shkollave”.

- Tarifa për dhënien në përdorim të mjediseve sportive të shkollave të destinuara për organizimin e veprimtarive sportive (palestra sportive) është 200 lekë/orë.
 - Struktura e ngarkuar për mbledhjen e këtyre tarifave do të jetë Qendra Ekonomike e Arsimit, dhe sipas akt rakordimeve në fund të çdo muaji, të konfirmuara nga Dega e Thesarit, të ardhurat do të kalojnë në llogarinë e Bashkisë Durrës.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare.


Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.07.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 569 / prot.
/ 2

Durrës, më 30.07 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.89 datë 26.07.2021

Për një ndryshim në VKB nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” në lidhje me dhënien në përdorim të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

